



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.80/1 Prot.

Tiranë, më 27/01/ 2021

### V E N D I M

**Nr.11, Datë 27 /01/ 2021**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.3 Regj, datë 12.01.2021, paraqitur nga E.B, kundër Departamentit të Gjuhës Frënge, të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, me pretendimin se procedura e ndjekur për angazhimin e personelit akademik me kohë të pjesshme në këtë departament, është diskriminuese. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në lidhje me diskriminimin e pretenduar, ankuesja ka parashtruar se<sup>2</sup>:

Jam pedagoge e jashtme që prej vitit 2015, në Departamentin e Gjuhës Frënge, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Procedura e përzgjedhjes të personelit akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Gjuhës Frënge, për vitin akademik 2020-2021, ka patur mungesë transparence dhe diskriminim në shpërndarjen e orëve të pedagogëve të jashtëm. Konkretisht nuk më janë ofruar orë në semestrin e parë të vitit aktual akademik, ndërkohë që i është dhënë përparësi përzgjedhjes së një kandidateje tjetër, e cila ka konkuruar këtë vit në thirrjen publike për rekrutimin e personelit akademik me kohë të pjesshme. Kandidatja është përzgjedhur dhe tashmë është angazhuar si pedagoge e jashtme gjë që bie në kundërshtim me kriterin e veçantë

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Parashtrimet e ankueses janë pasqyruar në mënyrë të përmblodhur.

në thirrjen publike për rekrutimin e pedagogëve me kohë të pjesshme. Theksoj se pedagogët e angazhuar prej vitesh, nuk u është dashur t'i nënshtrohen konkursit të këtij viti.

I jam drejtuar shefes së departamentit, datë 04 dhjetor 2020, për të më konfirmuar nëse do të angazhohesha këtë vit si pedagoge e jashme. Përgjegjësja e departamentit, znj.A.F më argumenton se ka rënie të ndjeshme të grupeve dhe një pjesë e pedagogëve të brendshëm janë angazhuar me orët e gjuhës frënge, por mund të na angazhojë nëse krijohet mundësia. Shefja e departamentit shkruan se kandidatja e përzgjedhur, është një person me historik të gjatë në mësimdhënie në departament dhe jo vetëm, ndërkohë që bie në kundërshtim me veten e saj dhe njëkohësisht me thirrjen publike, por edhe me faktin se pedagogia e përzgjedhur i është nënshtruar konkursit. Kjo tregon se pedagogia në fjalë nuk ka përvojën e duhur universitare për t'u futur pa konkurs, si pjesa tjetër e pedagogëve të cilët nuk i'u nënshtruan konkursit, por u futën automatikisht me dosje (siç është rasti im)

Në komunikimin e radhës i kërkoja znj.A.F transparencë për përzgjedhjen në fjalë si dhe kriteret e përvojës universitare të kandidatit të përzgjedhur, për të cilën nuk më ktheu përgjigje. Nëse do t'i referohemi nenit 11 dhe 15 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shefja e departamentit, përveç faktit se ka kryer diskriminim, ka tejkaluar gjithashtu afatin e kthimit të përgjigjes për të më informuar për përvojën universitare të kandidatës së përzgjedhur dhe për transparencën e procedurës të përzgjedhjes së saj kundrejt mosangazhimit tim me orë mësimore.

Në mungesë të një përgjigje sqaruese, në vijim i jam drejtuar dekanit, i cili më priti në takim, por nuk më dha zgjidhje konkrete për procedurën e ndjekur nga shefja e departamentit A.F. Dekani u shpreh se për këtë situatë duhet të përgjigjet shefja e departamentit.

Sjell në vëmendje se në thirrjen publike, te kriteret e veçanta citohet se kanë përparësi kandidatët me diplomë Postmaster ose Doktoraturë, me tituj dhe që kanë përvojë mësimdhënieje në arsimin universitar në fushën e gjuhësisë dhe letërsisë frënge. Sipas këtij kriteri të veçantë, përparësi duhet të kishin të gjithë pedagogët që kanë qenë përfshirë gjatë këtyre viteve si pedagogë të jashtëm, duke qenë se është kriter për mësimdhënie në arsimin universitar dhe jo parauniversitar. Kandidati i përzgjedhur vjen nga fusha e arsimit parauniversitar dhe nuk ka përvojën universitare sa pedagogët e jashtëm të përfshirë prej vitesh në këtë departament.

Gjithashtu bazuar në argumentin e znj.A.F, meqënëse ka një rënie të konsiderueshme të orëve do duhej që orët t'i jepeshin një kandidateje, e cila sipas kriterëve në thirrjen publike, nuk mund të ketë përparësi kundrejt pedagogëve që janë angazhuar prej vitesh si të jashtëm. Pra, në dhënien e orëve të kësaj pedagogeje nuk është zbatuar renditja sipas viteve të eksperiencës/përvojës universitare dhe formimit profesional.

Procedura e ndjekur nga përgjegjësja e departamentit ka:

- Diskriminim në përzgjedhjen e pedagoges së angazhuar duke mos konsideruar pjesën tjetër të pedagogëve të jashtëm të angazhuar prej vitesh në këtë departament, duke i dhënë përparësi një kandidati që nuk ka përvojën universitare sa ajo e pedagogëve të jashtëm të angazhuar prej vitesh, e cila bie ndesh dhe me kriterin e veçantë të shpallur në thirrjen publike.
- Mospërgjigje ndaj informacionit të kërkuar për të bërë transparente procedurën e përzgjedhjes së këtij kandidati dhe të përvojës universitare (psh pikëzim sipas kritereve që çon përzgjedhjen e kësaj pedagogeje duke mos angazhuar pedagogë të jashtëm që janë angazhuar prej vitesh)

Ankuesja kërkon nga Komisioneri marrjen këtyre masave :

- Rikthimin e orëve mësimore si pedagoge e jashtme.
- Verifikimin e procedurës së ndjekur për të angazhuar me orë mësimore pedagogët me kohë të pjesshme për këtë vit akademik
- Vendosjen e sanksioneve administrative/masa të tjera, nëse e gjykon të arsyeshme, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, ndër të tjera në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e ankueses. Për këtë arsye, nëpërmjet *email*-it të datës 11.01.2021, ankueses i’u kërkuar të përcaktojë dhe dokumentojë shkakun/shkaqet e pretenduara si diskriminues dhe të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm.

Me *email*-et datë 11 dhe 12 janar 2021, ankuesja ka dërguar sqarimin e saj, duke përcaktuar se shkakun për të cilin pretendon diskriminimin është në kuadër të parashikimit “*çdo shkak tjetër*” duke e shpjeguar shkakun e pretenduar si diskriminues si vijon: “*1. Diskriminim dhe mungesë transparence në procedurën e përzgjedhjes së personelit akademik me kohë të pjesshme (në shpërndarjen e orëve) duke i dhënë përparësi një kandidati që nuk ka përvojë universitare sa pedagogët e jashtëm të angazhuar prej vitesh. 2. Tejkallim afati për informacionin e kërkuar elektronikisht, bazuar në nenin 11 dhe 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.*

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen

*civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*” Ndërsa në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se: “*Diskriminim i drejtpërdrejtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”

Referuar parashikimit të nenit 1, marrë së bashku me përkufizimin e diskriminimit, që ligji ka bërë në nenin 3, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Neni 1, i ligjit, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Për të vlerësuar nëse pretendimet e ankueses në lidhje me shkakun e mbrojtur gëzon mbrojtje nga parashikimi “çdo shkak tjetër”, Komisioneri do të mbajë në konsideratë praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut<sup>3</sup>, në drejtim të interpretimit të shkaqeve/statuseve të tjera sipas nenit 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut<sup>4</sup>.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, objektive ose personale, ose “status”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.<sup>5</sup> Gjykata ka theksuar se fjalës “shkak/status tjetër” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.<sup>6</sup> Gjykata fillimisht vëren që, ndërsa një numër i shembujve konkretë kanë të bëjnë me karakteristikat që mund të thuhet se janë “personale” në kuptimin që ato janë karakteristika të lindura ose të lidhura natyrshëm me identitetin ose personalitetin e individit, të tilla si seksi, raca dhe feja, jo të gjitha shkaqet e listuara mund të karakterizohen kështu.

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën GJEDNJ.

<sup>4</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën KEDNJ.

<sup>5</sup> Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70.

<sup>6</sup> Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

Duke mbajtur në konsideratë standartin e mësipërm, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk ka identifikuar një shkak për trajtimin e padrejtë apo më pak të favorshëm, të pretenduar prej saj. Për diskriminimin e pretenduar ankuesja duhet të identifikonte një shkak, i cili ka shërbyer si bazë për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të pretenduar nga ana e saj.

Thelbi i pretendimeve të ankueses, qëndron në faktin se, procedura për angazhimin e personelit akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Gjuhës Frëndege, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, nga ana e shefes së këtij departamenti, është në kundërshtim me kriteret e shpallura dhe se procedura është zhvilluar në mungesë të transparencës. Kjo mund të përbëjë paligjshmërinë e kundërshtuar nga ankuesja, e cila njëkohësisht konsiderohet prej saj, si sjellje diskriminuese. Duke pretenduar se paligjshmëria e kundërshtuar përbën njëkohësisht edhe diskriminim, ankuesja i është drejtuar Komisionerit me ankesë.

Bazuar në përkufizimin që ligj i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Që një sjellje e paligjshme të konsiderohet si diskriminuese, duhet që ankuesi minimalisht të identifikojë dhe të provojë shkakun e pretenduar. Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesja nuk ka identifikuar një shkak për të cilin pretendon se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme, pra për të cilin pretendon se është diskriminuar.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankueses nuk mund të konsiderohen pretendime për diskriminim, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar. Bazuar në nenin 32/1/a, të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin *“Për barazinë gjinore në shoqëri”*.

Bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet : *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ..... b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”*

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në neni 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri i rekomandon ankueses, që në lidhje me paligjshmërinë e pretenduar në ndjekjen e procedurës së ndjekur për angazhimin e personelit akademik me kohë të pjesshme në

Departamentin e Gjuhës Frënge, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, të ndjekë rrugët administrative dhe gjyqësore, sipas parashikimeve ligjore.

Ndërsa në lidhje me mungesën e transparencës dhe cënimin e të drejtës për informim, ankuesja rekomandohet që t'i drejtohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si autoriteti kompetent.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” dhe nenin 33 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës Nr.3 regj., datë 12.01.2021, të paraqitur nga ankuese E.B.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Pa shkak  
Fusha: Punësim  
Lloji i vendimit: Mospranim